



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

VENDIM

Nr. 10, datë 27/04/2021

MBI

“MIRATIMIN E PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË TË STUDIMIT “DOKTOR” NË AKTRIM, REGJI, REGJI FILMI, SKENOGRAFI-KOSTUMOGRAFI DHE KOREOGRAFI, TË PARAQITUR NGA DEPARTAMENTI REGJI DHE REGJI FILMI DHE TELEVISIONI PRANË FAKULTETIT TË ARTIT SKENIK

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në nenin 79 të ligjit nr. 80/2015, për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit të MASR nr. 1, datë 14/01/2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucioneve të arsimit të lartë” (i ndryshuar me Udhëzimin nr. 7, datë 31.03.2021), VKM nr. 41, datë 24/01/2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, (i ndryshuar me VKM nr. 879, datë 18/12/2019 si dhe VKM nr. 185, datë 25.03.2021), pasi shqyrtoi dhe diskutoi dokumentacionin e paraqitur nga Fakulteti i Artit Skenik me nr. 130 prot., datë 22.04.2021 dhe të UART me nr. 451 prot., datë 26.04.2021, me votim të hapur unanimisht,

VENDOSI:

1. Miratimin paraprak të dokumentacionit për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë të studimeve “Doktor” në “Aktrim, Regji, Regji Filmi, Skenografi-Kostumografi dhe Koreografi”, të paraqitur nga Departamenti Regji dhe Regji Filmi dhe Televizioni pranë Fakultetit të Artit Skenik, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ky Vendim si dhe dokumentacioni i dërguar nga Fakulteti i Artit Skenik me nr. 130 prot., datë 22.04.2021 dhe të UART me nr. 451 prot., datë 26.04.2021, ti dërgohet për miratim paraprak Bordit të Administrimit të Universitetit të Arteve. Pas miratimit nga BA të ngarkohet brenda datës të afatit të përcaktuara në platformën e-Albania nga Përgjegjësi i Njesisë Bazë Regji dhe Regji Filmi dhe Televizioni.
3. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Artan PEQINI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Arben LLOZI

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Kastriot TUSHA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Endri SINA

Prof. Asoc. Gjergj PREVAZI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Dea SHUBLEKA (Studente FAB)

Sindi ZDRAVA (Studente FM)